



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Në ankesën e**

**AC-I-22-0492-A0001**

**Paditësi/ankuesi**

**N R,** Shtime.

**kundër**

**E paditura**

**NSH, "Shtime"(në likuidim),** të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5278 të datës 08 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 28 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së C-IV-14-5278 i datës 08 gusht 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 11 korrik 2014, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë për rishikim të vendimit nr. PRN020-0034, të datës 12 qershor 2014 të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilën ka kërkuar që të kompensohet për tre paga të papaguara, në shumë prej 450.00 euro (3x150.00 €), nga NSH "Shtime" (në likuidim). Paditësi pohoi se NSH nuk i kryer obligimet ndaj punëtorëve pas dhe gjatë procesit të privatizimit, për të cilën AKP, Zyra Regjionale në Prishtinë nuk ka dhënë asnjë sugjerim, asnjë formë të pagesës dhe asnjë sqarim. Paditësi ka pohuar se AKP nuk ka mbuluar asnjë lloj shpenzimi për periudhën e lartpërmendur, ashtu që punëtorët e Kooperativës Bujqësore "Shtime" janë angazhuar vazhdimisht dhe nuk kanë marrë asnjë lloj pagese, e aq më keq kur AKP e mohon të drejtën ligjore, e që është në kundërshtim të plotë me dispozitën e nenit 40 par. 1.6.1 të Ligjit mbi AKP të kufizuar në 3 paga mujore bruto. Paditësi tutje ka theksuar se procesi i privatizimit ka zgjatur jashtëzakonisht shumë dhe se në nëntor të vitit 2013 janë informuar për procesin e likuidimit me shkrim nga ana e AKP e që e kanë shfrytëzuar afatin ligjor dhe kanë aplikuar me kërkesë për të drejtën ligjore dhe se konsideron se kërkesa për paga nuk është parashkruar. Paditësi ankesës i ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar të AL.

Me 22 prill 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë dhe pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore. AKP-ja e mbështet në tërësi vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke iu referuar Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034, nenit 36.2.1, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar, për rrjedhën e afatit të parashkrimit. Më tej e paditura pohoi se nuk ka prova që ankuesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare të parashkrimit, pra tri vite nga korriku i vitit 2009. E paditura i ka propozuar Gjykatës që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e AL-së.

Me 30 maj 2022, përgjigja në ankesë e pashtuar nga AKP i është dorëzuar paditësit, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar ndonjë përgjigje.

Me 08 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktgjykimin C-IV-14-5278, me të cilën ankesën e paditësit për tre paga e ka refuzuar si të pa bazuar, dhe ka vërtetuar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN020-0034, të datës 12 qershor 2014. Shkalla e I-rë e ka arsyetuar se në rastin konkret bazuar në nenin 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenin 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës përkatësisht paditësit, që në parashtrësat e tija me shkrim, të paraqes një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor. Tutje ka arsyetuar se në rastin kur pala pohon, në këtë rast paditësi të ekzistoj një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi. Shkalla e I-rë për me tepër ka konstatuar se paditësi nuk ka dëshmuara të drejtën e tij mbi kompensimin siç parashihet në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në paragrafi 1.6 pika 1.6.2 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç përshihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenin 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Me 24 gusht 2022, paditësi ka parashtruar pranë Kolegjit të Apelit një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-5278 të datës 08 gusht 2022, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe aplikimit të gabuara të Ligjit material dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim ose të vendoset në mënyrë meritor lidhur me meritat e padisë. Paditësi në ankesën e parashtruar pranë Kolegjit të Apelit konsideron se Autoriteti i likuidimit nuk ka të drejtë të thirret në parashkrim, institut ky që vetëm gjykata mund ta zbatojë sipas prapësimit të palës kundërshtar. Paditësi me ankesë gjithashtu thekson se nuk ka qenë kontestuese fakti se e paditura i ka mbetur borxh 3 pagat e papaguara.

Me 21 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS, një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. AKP-ja i propozon Kolegjit të apelit që ta refuzojë ankesën e

paditësit si të pa bazuar dhe ta vërtetojë Aktgjykimin e ankimuar. Në këtë parashtrësë AKP-ja pohon se qëndrimin e saj lidhur me argumentet e Ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në Mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktgjykimin me nr.C-IV.-14-5278 nga DHPGJS, pranë shkallës së I-re. Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtare kërkon nga Kolegji i ankesave që t'i referohet Mbrojtjes dhe Aktgjykimit përkatës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren paditësi kishte dorëzuar kërkesë me 24 tetor 2013 për kompensimin e tre pagave të pa paguara në shumë prej 450.00 euro (3x150.00 €), nga NSH "Shtime", mirëpo AL e kishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Po ashtu AL kishte arsyetuar se paditësit nuk i takojnë automatikisht tre paga të papaguara por i jep prioritet tre pagave të fundit që mund të kenë mbetur të papaguara nga totali i paga që ndërmarrja nuk i ka paguara punonjësve. AL tutje në vendim kishte arsyetuar se kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet në prova që vërtetojnë një detyrim të tillë të ndërmarrjes.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë, ka pohuar se NSH nuk i kryer obligimet ndaj punëtorëve pas dhe gjatë procesit të privatizimit, për të cilën AKP, Zyra Regjionale në Prishtinë nuk ka dhënë asnjë sugjerim, asnjë formë të pagesës dhe asnjë sqarim. Paditësi ka pohuara se AKP nuk ka mbuluar asnjë lloj shpenzimi për periudhën e lartpërmendur, ashtu që punëtorët e Kooperativës Bujqësore "Shtime" janë angazhuar vazhdimisht dhe nuk kanë marrë asnjë lloj pagese. Paditësi e konteston aplikimin e dispozitave ligjore, nga ana e gjykatës lidhur me parashkrimin duke e konsideruar se këto dispozita ligjore nuk duhet të aplikohen.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-5278, të dt. 08 gusht 2022, ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar dhe ka vërtetuar Vendimi i Autoritetit të likuidimit PRN020-0034, të datës 12 qershor 2014.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa e paditësit për tre paga të papaguara në shumë prej 450.00 euro, ishet e pabazuar, meqë paditësi nuk ka dëshmuara të drejtën e tij mbi kompensimin siç parashihet në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në paragrafi 1.6 pika 1.6.2 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç përshihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Edhe Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi kërkesën për kompensimin e tre pagave të papaguara, në shumë prej 450.00 €, nuk e ka mbështetur me asnjë provë para Shkallës së I-rë, prandaj Aktgjykimi i ankimuar konsiderohet si i drejtë dhe i ligjshëm. Paditësi me ankesë para Shkallës së I-rë nuk kishte ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH. K.B "Shtime" i ka mbetur borxh pagat e kërkuara. Kopja e Vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, të cilën si të vetëm e ka bashkangjitur paditësi nuk dëshmon për ndonjë detyrim-borxh të N.SH-së ndaj paditësit.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *"pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e*

*pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”, ndërsa pika 3 parasheh se “pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”.*

Kolegji i Apelit vëren se paditësi edhe në Shkallë të II-të përveç pretendimit për të drejtën e tij në tre paga nuk ka bashkangjitur ndonjë provë me të cilën do vërtetohej detyrimi i NSH ndaja tij, andaj bazuar dispozitave të lartcekura Kolegji I Apelit vlerëson se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Kolegji I Apelit vëren se Shkalla e I-rë e DHPGJS kërkesën e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar në mungesë të provave e jo për shkak të parashkrimit ashtu siç pretendon paditësi në ankesë, duke u thirrur në atë se Shkalla e I-rë ka aplikuar në mënyrë të gabuara të drejtën materiale sa i përket parashkrimit, prandaj përdimet e paditësit në këtë aspekt janë të pabazuara. Në fakt aktgjykimi përmban përmbledhje të rastit të palëve ndërgjyqës, përmban prezantim të gjitha fakteve që kenë rendësi materiale për rastin, i njëjti ofron shpjegim të qartë dhe të hollësishëm të dispozitave ligjore dhe arsyetimit lidhur me refuzimin e kërkesës për shkak të mungesës së provave të dorëzuar nga paditësi. Gjithashtu nga shkresat e lëndës vërehet se me 30 maj 2022, përgjigja në ankesë e pashtuar nga AKP i është dorëzuar paditësit, mirëpo i njëjti nuk ka pashtuar ndonjë përgjigje, prandaj pretendimi i paditësit se gjykata nuk ka dhënë mundësi paditësit për të dozuar prova në mbështetje të ankesë së tij është e pa pabazuar. Paditësi dorëzimin e provave ka mundur ta bëjë në Shkallë të I-rë gjatë procedurës me shkrim e cila është procedurë e veçantë në DHPGJS, por ai nuk e ka bërë, prandaj pretendimi i tij edhe në këtë aspekt është i pabazuar.

Andaj nga këto arsye, ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.01/2017, të datës 22 mars 2017, paditësi nuk ngarkohet me taksë gjyqësore, meqë vlera e kontestit është nën shumën prej 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 28 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_